



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 140 Akti

Nr. 188 Vendimi

Tiranë, më 24.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh - Bakels, në Tiranë, më datë 22 korrik 2019, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Maela Alicanaj, me detyrë ish- ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, pa përfaqësues.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, znj. Maela Alicanaj, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 22.07.2019, kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Maela Alicanaj, ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë nga muaji korrik 2011 deri në 1.10.2018, kur ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës.
- ii. Subjekti ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, DSIK-së dhe KLD-së dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016;
- iii. Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj;
- iv. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim si Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15 maj 2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët e sipërcituar;
- v. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 4, pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 24 maj 2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit;
- vi. Pasi përfundoi faza hetimore mbi rivlerësimin e znj. Maela Alicanaj, më datë 21 qershor 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet, dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të trija kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016;
- vii. Më datë 25.06.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht duke e ftuar (ii) për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë 11 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet;
- viii. Subjekti kërkoi më shumë kohë dhe Komisioni e pranoi kërkesën e saj;
- ix. Më datë 11 korrik 2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e veta, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht;
- x. Më datë 15.07.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 4, dërguar përmes postës elektronike, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 22 korrik 2019.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh – Bakels;
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, znj. Maela Alicanaj, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj;
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 22.07.2019 u mbyll, për të rifilluar më datë 24.07.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; c) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) Raportin e përpiluar nga Inspektorati i Lartë i KLD-së dhe dokumentet shkresore të përcjella nga Shkolla e Magjistraturës; f) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; g) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore; h) faktet e njohura botërisht.

A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. ***, datë 19.04.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, ku konstatohet se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

- i) **Truall me sipërfaqe 154 m² dhe ndërtesë¹ me sipërfaqe 83.80 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier.**
- ii) Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike e vitit 2013, si dhe në deklaratën “Vetting”, me pjesë takuese 50%, për subjektin dhe bashkëshortin e saj, e përfituar nga kontrata e shkëmbimit e datës 26.03.2013, me vlerë 35.720 euro².
- iii) Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Kontratë shkëmbimi nr. *** rep, nr. *** kol, datë 26.09.2013 me pasurinë apartament banimi³ me nr. pasurie ***, ndodhur në ***, Tiranë, komuna ***, zona kadastrale ***;
- iv) Nga analiza e përgjigjeve të institucioneve dhe të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se ZVRPP-ja Fier e konfirmon këtë pasuri në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe njëkohësisht nga verifikimi i kartelës së pasurisë rezulton se ajo është hipotekuar në favor të “BKT”-së. Sipas dokumentacionit të ZVRPP-së Fier rezulton se me kontratën e shitjes datë 15.04.1992, zyra e DAK Privatizimit Fier i ka shitur znj. N. A. depon e grumbullimit të letrës në vlerën 2.267 lekë.
- v) Po në këtë datë është përpiluar edhe aktdorëzimi i objektit, në të cilin, ndër të tjera, pasqyrohet se sipërfaqja e tokës që zë objekti është 181 m².
- vi) Me mandatarkëtimin nr. *** është bërë blerja për llogari të seksionit të financës Fier në shumën 2.267 lekë. Po sipas këtij dokumentacioni rezulton se me kontratën e shitjes nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.06.2001, Agjencia Kombëtare e Privatizimit i ka shitur blerësit N. A., përkatësisht nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, truallin me sipërfaqe funksionale të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të objektit “Magazina e grumbullimit të letrës” Fier, 181 m² (nga e cila nën objekt 90 m²), në vlerë 130. 320 lekë, vlerë e cila në kontratë është cituar se është derdhur e gjitha para kohës së përpilimit të kontratës, sipas mandatarkëtimimit AA nr. ***, datë 30.05.2001.

¹ Përfituar në bazë të Kontratës së shkëmbimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.09.2013.

² Vlera e prejardhur nga vlera e pasurisë nr. ***, me sipërfaqe 69.3 m² ndodhur në ***, Tiranë, e përdorur për t’u shkëmbyer;

³ Apartamenti i ndodhur në ***, rezulton i blerë tek shoqëria “****” sh.p.k., dhe si palë blerëse rezulton personi i lidhur me subjektin (bashkëshorti i saj), sipas kontratës së shitjes nr. *** rep, *** kol, datë 20.03.2012, me vlerë 35.720 Euro. Për pagesën e kësaj pasurie është deklaruar se është marrë kredi bankare afatgjatë prej 30.000 euro me palë kredidhënës “Banka Popullore” sh.a, dhe kredimarrës subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, (bashkëshorti), sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 03.06.2009, dhe pjesa tjetër nga kursimet. Por në pyetësorin nr. 3, datë 29.03.2019, subjekti shprehet se ka paguar 10.000 euro nga të ardhurat e veta dhe të bashkëshortit;

- vii) Sipas autorizimit nr. *** prot, datë 28.05.2001, administruar në këtë praktikë rezulton se është autorizuar shitja e sipërfaqes së domosdoshme të objektit magazinë e grumbullimit të letrës në pronësi private të znj. N. A. Në praktikën e ZVRPP-së është administruar edhe mandatarkëtimi i shumës për blerjen e truallit objekt hetimi administrativ.
- viii) Pasuria pas privatizimit është regjistruar sipas kartelës së pasurisë në emër të N. A., si pasuria me sipërfaqe 154 m² truall dhe ndërtesë 83.80 m², në përshkrimin e veçantë të të cilës thuhet shprehimisht se “*Vijon nga pasuritë *** me numër ***, vol. ***, fq. ****) me nr. *** me vol. ***, fq. ***, magazinë një kat.”
- ix) Në kartelën e pasurisë në seksionin “E” pasuria figuron e hipotekuar në favor të bankës “Societe Generale Albania”, sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 03.04.2012.
- x) Për këtë pasuri është lëshuar në datë 5.09.2013 certifikata përkatëse e pronësisë.
- xi) Kjo pasuri ka kaluar nga shtetasja N. A. tek djali i saj, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. *** rep. nr. *** kol, datë 26.09.2013.
- xii) Gjithashtu, sipas dokumentacionit të administruar në praktikën e ZVRPP-së Fier, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar këtë pasuri, duke dhënë pasurinë e paluajtshme në pronësi të tij, e përshkruar si apartament që ndodhet në *** - Tiranë, me sipërfaqe 69.3 m², zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***. Sipas kësaj kontrate pasuritë janë shkëmbyer së bashku me kufizimet hipotekore me pëlqimin e bankës “Societe Generale Albania” sh.a. pa cenuar të drejtat e palëve. Në këtë kontratë shkëmbimi ka dhënë pëlqimin edhe subjekti i rivlerësimit për shkëmbimin e këtyre pasurive, me cilësinë e bashkëshortes.
- xiii) Me deklaratën noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.03.2013, banka “Societe Generale Albania” sh.a., ka dhënë pëlqimin e kalimit të kësaj pasurie tek bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, së bashku me barrën hipotekore për shkak të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në shumën 7.700.000 lekë me normë interesi *bono thesari* 12 muaj vitin e parë dhe *bono thesari + marzhin* prej 2% në vitet në vazhdim, me kontratë për kredi bankare afatgjatë nr. ***, datë 03.04.2012, redaktuar tek noteri me nr. *** rep, nr. *** kol, datë 03.04.2012. Më tej kufizimi hipotekor për këtë pasuri ka kaluar në favor të “BKT”-së sipas kontratës së hipotekimit nr. *** rep. nr. *** kol, datë 10.02.2016⁴.

Nga hetimi ka rezultuar se mospërputhjet lidhur me deklarin e sipërfaqes së kësaj pasurie në deklaratën periodike 2010 dhe atë “Vetting”, i referohen gabimeve të hasura gjatë regjistrimit të pronës nga ZVRPP-ja Fier. Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë dhe me korrektësi sipërfaqen, referuar dokumentacionit që ka administruar përkatësisht sipas kohës. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi këtë pasuri.

Nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, pasi provat e analizuara dhe dokumentet e administruara provojnë bindshëm krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme. Nga hetimi administrativ nuk u rezultuan pasaktësi apo fshehje të aseteve në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

⁴ Referojuni kartelës së pasurisë në praktikën shoqëruese *** të ZVRPP-së Fier tek dokumentacioni që i bashkëlidhet shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot, datë 03.11.2017, në dosjen e Komisionit.

1. Apartament banimi me sipërfaqe 76 m² në *** – Tiranë.

- i. Kjo pasuri rezulton të jetë porositur sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.02.2009. Nga dokumentacioni i administruar rezulton që ky apartament është blerë në vlerën 35,720 euro⁵;
- ii. Pagesat e çmimit të mësipërm, sipas deklarimeve të subjektit⁶ janë financuar në shumën prej 10,000⁷ euro nga të ardhurat dhe kursimet e subjektit dhe bashkëshortit të vet, kurse pjesa tjetër me kredi;
- iii. Rezulton që subjekti, për këtë blerje, më datë 02.06.2009, është financuar me kredi bankare në “Bankën Popullore”⁸ sh.a., në shumën prej 30,000 euro;
- iv. Siç u përmend edhe më lart, blerja e kësaj pasurie, edhe pse nuk është më në pronësinë e subjektit, analizohet pasi ky apartament është shkëmbyer me pasurinë nr.1, të deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe është pronësi të një personi tjetër të lidhur;
- v. Sipas kartelës përkatëse të pasurisë, provë e administruar në praktikën e ZVRPP-së Fier, rezulton se apartamenti në fjalë është regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me nr. pasurie ***, me vendodhje ***, Tiranë, me sipërfaqe 69.3 m²;
- vi. Kjo pasuri⁹ është fituar me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.03.2012 lidhur përpara noterës L. K.. Pasuria është blerë nga bashkëshorti i subjektit, shitëse rezulton shoqëria “***” sh.p.k, me sipërfaqe 69.3 m², sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 6.7 m² sipërfaqe e përbashkët e ndodhur në ***, Tiranë, në shumën 35.720 euro, pagesë e cila sipas kësaj kontrate është likuaduar totalisht jashtë zyrës noteriale;
Për këtë pasuri rezulton se është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie. Në kartelën e pasurisë në seksionin “E” rezulton se apartamenti ka qenë i kufizuar për llogari të bankës “Societe Generale Albania”.

2.1 Nga sa më sipër, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me burimet financiare të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, pasi ato kanë rezultuar të justifikuara. Deklarimet e subjektit në lidhje me veprimet juridike të përfitimit dhe shkëmbimit janë kryer në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Nga të gjitha rrethanat e faktit dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, pasi provat e analizuar dhe dokumentet e administruara provojnë bindshëm krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme. Nga hetimi administrativ nuk rezultuan pasaktësi apo fshehje të aseteve në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

⁵ Paguar pranë bankës “Societe Generale Albania” në datën 09.06.2009, shuma prej 25.720 euro në favor të F. B.

⁶ Deklarimi para fillimit të detyrës në vitin 2010 si dhe deklarimet në pyetësorë gjatë hetimit administrativ.

⁷ Sipas sqarimeve dhënë në pyetësorin nr. 3, datë 29.03.2019 subjekti shprehet se ka paguar 10.000 eruro, nga të ardhurat e veta dhe të bashkëshortit, (kësti i parë i paguar sipas kontratës së porosisë), shuma të cilat nuk ishin specifikuar në deklaratën e vitit 2010.

⁸ Sot, “OPT Bank Albania” sh.a. (ish-Societe Generale Albania).

⁹ Referojuni aneksit 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

2. Apartament me sipërfaqe 215 m², porositur në vlerë 73.340 euro, në ***, Tiranë

- i. Në deklaratën “Vetting”, subjekti e deklaroi këtë pasuri, të porositur me kontratën e datës 25.01.2012, me pjesë takuese 50%, me vlerë 18.335 euro¹⁰, ndërsa burimin financiar të krijimit të tij e deklaroi jo në faqen përkatëse, por në rubrikën e faqes nr.11 të deklaratës “Vetting”;
- ii. Në deklaratën për vitin 2012 subjekti e deklaroi me përshkrim “Kontratë porosie për blerje apartamenti, datë 25.01.2012, nr. *** rep., nr. *** kol., (notere N. K.), me sipërfaqe 215 m² në vlerën 18.000 euro, në pjesë zotëruese 50%”;
- iii. Në deklaratën e vitit 2012 nga subjekti nuk është deklaruar burimi financiar që ka mundur pagesat për këtë apartament, ndërsa në deklaratën “Vetting”, është pasqyruar ky burim në faqen nr. 11 të kësaj deklaratë;
- iv. Nga kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.01.2012, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka porositur tek shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin nr. ***, shkalla ***, në katin e *** banim, me sipërfaqe neto 193 m² dhe me sipërfaqe të përbashkët 22.42 m², në total 215.42 m², me 350 euro për metër katror, në shumën totale 73.340 euro;
- v. Sipas kontratës të sipërcituar – para nënshkrimit të saj është likuajduar kësti i parë prej 18.335 euro, ndërsa është rënë dakord që kësti i dytë dhe i fundit prej 55.005 euro do të shlyhet menjëherë pas disbursimit të kredisë nëpërmjet bankës. Gjithashtu, në kontratë është përcaktuar se çdo pagesë do të vërtetohet me mandatpagesat përkatëse të lëshuara nga banka;
- vi. Për këtë pronë rezulton se është paguar vetëm kësti i parë dhe se prona nuk është e regjistruar ende në emër të subjektit, pasi ZVRPP-ja Tiranë¹¹ nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj;
- vii. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se burimi financiar për likuidimin e këtij apartamenti do të ishte kredia bankare¹² dhe kursimet e veta¹³, pasi subjekti ka marrë kredi në bankën Societe Generale shumën **7,700,000**¹⁴ lekë për apartament, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2012, për blerje apartamenti – të deklaruar në DPV 2012;
- viii. Por, sipas deklaratës “Vetting”¹⁵ dhe sipas pohimeve që ka bërë subjekti gjatë hetimit administrativ në lidhje me përdorimin e kësaj kredie sipas qëllimit për të cilin është marrë, kredia është përdorur për (i) shlyerjen e një detyrimi të paparashikuar ndaj shtetasit G. D., detyrim i deklaruar rregullisht nga subjekti edhe në deklaratën e vitit 2012, si edhe burimi për shlyerjen e këtij detyrimi ishte kjo kredi; (ii) mbylljen e detyrimit për shoqërinë “Leasing” dhe (iii) paradhënien për blerjen e mjetit të ri Peugeot 308 SW;

¹⁰ Sipas kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.01.2012, është paguar kësti i parë në vlerën 18,335 euro ose 2,561,766 lekë. Nga sqarimet e dhëna në pyetësin nr. 3, datë 29.03.2019, gjendja mbetet pezull dhe nuk ka zhvillime të mëtejshme për këtë pasuri;

¹¹ Referojuni shkresës nr. *** prot, datë 10.08.2018, në dosjen e Komisionit, në përgjigje të shkresës së KPK-së nr. ***prot., datë 05.07.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë;

¹² Shuma e kredisë 7,700,000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2012;

¹³ Për sa i përket kështit të parë, subjekti ka deklaruar që është paguar nga kursimet e veta dhe të bashkëshortit;

¹⁴ Subjekti në pyetësin nr. 3, datë 29.03.2019, është pyetur në lidhje me përdorimin e kësaj kredie sipas qëllimit për të cilin është marrë dhe shprehet se kredia nuk është përdorur për qëllimin për të cilin është marrë, por për mbylljen e detyrimit ndaj shtetasit G. D., mbylljen e detyrimit për shoqërinë “Leasing” dhe paradhënien për blerjen e mjetit të ri Peugeot 308 SW;

¹⁵ Faqe nr. 11 e deklaratës “Vetting”;

- ix. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se nuk ka detyrim të mbetur, si dhe që marrëdhënia midis palëve ka ngelur e ngrirë. Këto pohime janë konfirmuar dhe përsëritur nga subjekti edhe nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit të tretë;
- x. Për këtë pasuri subjekti ka deklaruar se për kontratën e porosisë për blerje apartamenti mes palës sipërmarrëse “****” sh.p.k. (shoqëri ku ishte i punësuar bashkëshorti i subjektit) është paguar vetëm kësti i parë, me vlerë 18.335 euro me të ardhura nga kursimet, nuk u përmbushën kushtet e kontratës për të paguar këstin e dytë dhe të fundit prej 55.005 euro, për shkak se vlera e kredituar nga kontrata *kredi bankare afatgjatë* me palë kredidhënës “Banka Popullore” sh.a., “Societe General Albania”, sh.a. dhe kredimarrës A. dhe Maela Alicanaj, shërbeu për kthim shume për anulimin e kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.2010 midis palës shitëse N. A. dhe palës blerëse G. D.;
- xi. Komisioni, më datë 28.05.2019, ka dëgjuar z. R. A., mbi rrethanat e mësipërme, i cili ka informuar lidhur me situatën për kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.01.2012, duke konfirmuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka porositur një apartament dhe ka paguar si paradhënie shumë prej 18.335 euro, dhe diferencën do ta paguanin me kredi. Sipas dëshmitarit A., subjekti dhe bashkëshorti i saj, nuk e kanë lëvruar kredinë e marrë për këtë apartament.

Në këto kushte ata kanë rënë dakord verbalisht se kjo marrëdhënie do të mbetet “e ngrirë” dhe se do të rivendosej sapo ndërtuesi A. të pajisej me një leje tjetër ndërtimi. Dëshmitari ka provuar me dokumentacion shitjen e këtij apartamenti tek blerës të tjerë dhe ka pranuar se shuma e parapaguar nuk është kthyer mbrapsht tek subjekti, por do të jetë në dispozicion, me konceptin e një parapagimi, për një apartament tjetër në të ardhmen. Shtetasi A., gjithashtu, ka konfirmuar marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit të subjektit në shoqërinë e tij, për një kohë të gjatë, nga buron edhe marrëdhënia e mirëbesimit ndërmjet tyre.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- xii. Lidhur me sa më lart, subjektit iu njoftuan rezultatet, dhe znj. Alicanaj paraqiti shpjegimet e veta dhe dokumente mbështetës, lidhur me rezultatet e hetimit;
- xiii. Subjekti ka sqaruar se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë porositur një apartament, tek shoqëria ku punonte bashkëshorti i saj, me funksion inxhinier/drejtues teknik i shoqërisë. Ata kishin paguar këstin e parë në shumë prej 18.335 euro dhe vlerën e mbetur do ta paguanin me shumën që do të merrnin nga një kredia bankare me kushte tregtare. Më pas, ata ishin gjendur përballë një ndryshimi të rrethanave familjare dhe financiare, të cilat i kishin detyruar të ndryshonin mendim, dhe të mos procedonin më tej me blerjen e apartamentit të porositur, por me shumën e marra nga kredia bankare të përballonin disa detyrime të tjera financiare, të shfaqura papritmas;
- xiv. Për këtë vendim, ata kanë njoftuar menjëherë administratorin e shoqërisë shitëse, i cili ka pranuar pa kundërshti këtë situatë, por në atë kohë ai nuk dispononte likujditet për të kthyer pas shumë prej 18.335 euro të parapaguar. Marrëdhënia mes tyre ishte edhe miqësore e më pas palët ishin dakordësuar që kjo shumë të mbetej në kasën e shoqërisë ndërtuese, si një paradhënie, për blerjen e një sendi/apartamenti në të ardhmen, sapo kjo shoqëri të merrte një tjetër leje ndërtimi në Tiranë;

- xv. Në vijim të rrethanave të mësipërme dhe akordit midis palëve, shoqëria ndërtuese vijoi me shitjen e apartamentit në fjalë tek persona të tretë. Porositësit rezervonin të drejtën e blerjes së një tjetër apartamenti, në një ndërtim të ardhshëm, duke konsideruar të parapaguar një këst (shuma prej 18.3350 euro);
- xvi. Lidhur me deklarimin në “Vetting” si vlerë të kontratës, vetëm shumën prej 18.335 euro, subjekti ka sqaruar se duke qenë se e vetmja vlerë e paguar ishte ajo, dhe duke mos patur detyrim tjetër për atë kontratë, e vetmja mundësi ishte deklarimi i shumës në fjalë dhe jo i vlerës totale, e cila nuk ishte më në fuqi. Por është shpjeguar qartë e gjithë rrethana në deklaratën “Vetting”, si dhe burimi i shumës së paguar, duke bërë kështu deklaram të vërtetë dhe të plotë;
- xvii. Subjekti ka vijuar në arsyetimin e saj, se pas këtyre ndryshimeve, ajo dhe bashkëshorti i saj nuk e konsideronin më ekzistuese kontratën e porosisë së datës 25.01.2012, pasi ajo – edhe pse nuk ishte revokuar formalisht – ishte prishur me mirëkuptim dhe marrëveshje dypalëshe, brenda lirisë kontraktore, dhe për rrjedhojë nuk konsiderohej më as ekzistenca e detyrimit të mbetur, prej 55.005 euro. Kjo edhe për faktin se kontrata ishte jo më e ekzekutueshme nga ana e shoqërisë së ndërtimit, për sa kohë e kishte tjetërsuar të njëjtin send, në favor të shtetasve të tjerë;
- xviii. Subjekti ka shtuar se nuk kishte detyrim që të kryente revokimin të kontratës së porosisë, për sa kohë e drejta e tyre për të marrë mbrapsht shumën e paguar (18.335 euro), kishte një afat të gjatë parashkrimi të pashteruar ende. Fakti që nuk ishte revokuar kontrata në fjalë - duke mos qenë një detyrim - nuk mund të penalizonte subjektin, dhe nuk mund të konsiderohej si i rremë deklarimi i kryer prej tij, sipas të cilit: *nuk kishte më asnjë detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese*. Subjekti ka shtuar se kjo rrethanë ishte shpjeguar në mënyrë të detajuar në deklaratën “Vetting”, përfshirë edhe ngrirjen e marrëdhënies kontraktore dhe financiare më shoqërinë punëdhënëse të bashkëshortit “***” sh.p.k.;
- xix. Gjithashtu, subjekti ka pohuar se për sa më lart, mbi këtë pikë, ajo e ka qartësuar edhe në procesverbalin me objekt: “Shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive” mbajtur më tetor 2016, ku është sqaruar kjo çështje dhe është shpjeguar se nuk ka detyrim të mbetur me shoqërinë ndërtuese;
- xx. Shpjegimet dhe qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, kanë qenë të njëjta edhe nga deklaramet e bëra përpara Komisionit nga z. R. A. – i dëgjuar në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., më 28.05.2019, si më lart.

Vlerësimi i Komisionit

- xxi. Komisioni pasi shqyrtoi të gjitha faktet dhe rrethanat, si dhe analizoi dokumentet shkresore dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, arrin në përfundimin se pasuria në objekt hetimi nuk ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, kjo për faktin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, me anë të kredisë së marrë, kanë përballuar një detyrim tjetër, të ndodhur në mënyrë të papritur dhe që ka qenë i paparashikueshëm.

Komisioni, vlerëson se vërtet kontrata e porosisë ishte lidhur dhe rezultoi e provuar se është paguar kësti i parë, por më tej, kjo kontratë është ndryshuar me sjelljen e palëve, duke e humbur qëllimin për të cilin ishte lidhur, dhe në një klimë mirëbesimi, ajo nuk ka vijuar të ekzekutohet, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj e kanë përdorur kredinë jo për qëllim të fitimit të kësaj pasurie. Pasuria objekt i asaj kontrate iu është kaluar të tretëve. Kjo u vërtetua me anë të dokumentacionit të paraqitur nga dëshmitari A.. Në të tilla rrethana, Komisioni vlerëson se ndryshimi i destinacionit të

kredisë nuk është bërë me synimin për t'iu shmangur ekzekutimit të kontratës së porosisë, por për një shkak të justifikuar.

Vetë kontrata e kredisë së dhënë nuk lidhej shprehimisht me sendin e porositur, por kishte si destinacion blerjen e një pasurie të paluajtshme dhe se shuma e lëvruar kishte kaluar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Ndryshimi i destinacionit të kredisë, në vetvete, nuk përbën ndonjë shkelje të dispozitave urdhëruese, ajo është një marrëdhënie private mes palëve. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ka marrë në konsideratë edhe faktin se, banka e interesuar lidhur me ndryshimin e destinacionit nuk e ka kundërshtuar atë dhe se ekzekutimi i kontratës së kredisë ishte kryer rregullisht.

Në bazë të rrethanave të faktit, dokumentacionit të administruar, provohet se ndryshimi i destinacionit të kredisë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është kryer duke zëvendësuar sendin e porositur me një send tjetër, duke vazhduar kështu rregullisht marrëdhënien e kredisë. Aftësitë financiare dhe garancitë e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në thelb nuk kanë ndryshuar.

Komisioni vlerëson se në të tilla rrethana, çështja e destinacionit të kredisë, në rastin konkret, duhet të përbëjë një atribut dhe tagër të bankës së interesuar dhe një marrëdhënie juridiko-civile, e cila nuk mund të përbëjë objekt përgjegjësie për etikën e subjektit sipas ligjit nr. 84/2016.

Nga analiza e deklaratave vjetore/periodike të deklarimit të pasurisë, hetimi administrativ i kryer si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe nuk është konstatuar ndonjë përpjekje për të fshehur pasuri apo ndonjë fakt në lidhje me kontratën e porosisë. Përkundrazi, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar marrëdhënien konkrete, ai ka qenë bashkëpunues, duke shpjeguar qartë shkaqet dhe arsyet e mosrespektimit të destinacionit të kredisë së marrë me normën e tregut, duke provuar bindshëm arsyet e qenësishme familjare, të cilat sollën ndryshim të situatës familjare.

Si përfundim, Komisioni vlerëson se të gjitha këto prova të çojnë drejt përfundimit se marrëdhënia kontraktore ka lindur, është kryer parapagimi i kështit të parë, dhe më pas, ka pësuar një ngrirje që prej janarit të vitit 2012. Për sa më sipër, nuk rezultojnë veprime të subjektit apo dokumentacion për të lindur dyshime mbi këtë marrëdhënie kontraktuale.

Në lidhje me pagimin e shumave sipas kontratës së datës 25.01.2015, në total një shumë prej 55,005 euro, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën periodike të vitit 2012 – në faqet që i përkasin bashkëshortit të saj, është deklaruar në faqen nr. *** kontrata e porosisë dhe qëllimi i kontratës së kredisë bankare për blerje apartamenti duke specifikuar, “pa kryer”.

Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” dorëzuar në 30 janar 2017 në faqen nr. 11 është deklaruar: *“Kontratë porosie për blerje apartamenti mes pales Sipërmarrëse “***” sh.p.k. (shoqëri ku ishte i punësuar bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A. A.. Është paguar vetëm kësti I, me vlerë 18.335 (tetëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) euro, me të ardhura nga kursimet. Nuk u përmbushën kushtet e kontratës për të paguar këstin II dhe të fundit prej 55.005 (pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) euro, për shkak se vlera e kredituar nga kontrata kredi bankare afatgjatë me palë kredidhënës “Banka Popullore” sh.a/ “Societe General Albania”, sh.a. dhe kredimarrës A. dhe Maela Alicanaj, shërbeu për kthim shume për anulimin e kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.2010 midis palës shitëse N. A. dhe palës blerëse G. D.. Detyrim të mbetur nuk ka. Marrëdhënia mes palëve ka mbetur e ngrirë.”*

- xxii. Nga analiza e deklaratave të pasurisë vjetore/periodike dhe në bazë të deklarimeve në deklaratën “Vetting”, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në deklaratën vjetore/periodike të vitit 2012 ka deklaruar kontratën e porosisë, po ashtu, në faqen nr.11 të deklaratës “Vetting” subjekti ka deklaruar edhe **burimin e pagesës së kështit të parë. Subjekti dhe bashkëshorti i saj**

kanë deklaruar: “Kontratë porosie për blerje apartamenti mes palës sipërmarrëse dhe e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit z. A. A.. Është paguar vetëm kësti I, me vlerë 18.335 (tetëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) euro, me të ardhura nga kursimet. Nuk u përmbushën kushtet e kontratës për të paguar këstin II dhe të fundit prej 55.005 (pesëdhjetë e pesë mijë e pesë) euro, për shkak se vlera e kredituar nga Kontratë kredi bankare afatgjatë me palë kredidhënës “Banka Popullore” sh.a/ Societe General Albania”, sh.a. dhe kredimarrës A. dhe Maela Alicanaj, shërbeu për kthim shume për anulimin e kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.2010 midis palës shitëse N. A. dhe palës blerëse G. D.. Detyrim të mbetur nuk ka. Marrëdhënia mes palëve ka mbetur e ngrirë”.

- xxiii.** Lidhur me deklarinimin e burimeve financiare që mundësuan pagesën prej 18.335 euro për këtë pasuri, Komisioni ka kryer analizën financiare, nga e cila rezulton se subjekti i ka patur mundësitë financiare për të kryer këtë pagesë.

Përshkrimi¹⁶	Viti 2012
Të ardhura nga puna subjekti	895.851
Të ardhura nga puna bashkëshorti	865.440
Të ardhura nga biznesi “***”	391.821
Të ardhura nga shitja e makinës së vjetër	568.660
Kredi për blerje apartamenti	7.700.000
Kredi për blerje makine	1.515.962
Pakësim të gjendjes <i>cash</i> ¹⁷ dhe bankës	1.038.056
TOTAL TË ARDHURA	12.975.790
Shlyerje detyrimi për G. D.	-5.240.330
Pagesë principali për kreditë	-812.811
Shpenzime ¹⁸	-1.424.119
Pagesë kësti I për blerje apartamenti	-2.540.422
Blerje makine	-2.160.517
TOTAL SHPENZIME	-12.178.199
REZULTATI	797.591

¹⁶ Kursi i përdorur sipas BSH-së: 1 euro = 139.72 lekë.

¹⁷ Subjekti deklaroi gjendje *cash* më 31.12.2011 shumën prej 23.000 euro ose ekuivalent i 3.213.560 lekë.

¹⁸ Këtu janë përfshirë shpenzime jetike, shpenzime udhëtimi, shpenzime me kartë krediti, shpenzime për interesa dhe paradhënie për blerjen e makinës.

Ky deklaram përputhet me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe ato të pyetësorit nr. 3, datë 29.03.2019. Nga të gjitha rrethanat e faktit dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e kështit të parë të kësaj pasurie, pasi provat e analizuara dhe dokumentet e administruara provojnë bindshëm disponibilitetin e të ardhura të ligjshme. Nga hetimi administrativ nuk rezultuan pasaktësi apo fshehje të aseteve në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

3. Apartament me sipërfaqe 51.9 m², me vlerë 25,690 euro, ndodhur në *, Komuna ***, Durrës;**

- i. Subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë pasuri në DPV të vitit 2015 si dhe në deklaratën “Vetting”;
- ii. Sipas kontratës së porosisë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2015 subjekti ka porositur¹⁹ blerjen e apartamentit në fjalë, me një çmim prej 25.690 euro, dhe ka paguar kështin e parë prej 5.138 euro;
- iii. Burimi i krijimit, për sa i përket kështit të parë, në vitin 2015 është deklaruar²⁰ të ketë qenë nga të ardhurat nga puna, nga dyqani dhe nga kontrata e qirasë. Në deklaratën “Vetting”, veç këtyre burimeve financiare, subjekti ka shtuar/specifikuar se të ardhurat nga dyqani i referoheshin biznesit “****” në emër të bashkëshortit;
- iv. Diferenca e çmimit prej 20.552 euro në deklaratën “Vetting”, subjekti ka përshkruar se është likuaduar nga kredia e marrë në “Bankën Kombëtare Tregtare”²¹;
- v. Njëkohësisht nga kjo kredi e marrë në shumën prej 9,334,800 lekë, është përdorur për likuidimin e çmimit të këtij apartamenti shuma prej 2,842,400 lekë, ndërsa pjesa tjetër (6.492,400 lekë) është përdorur për likuidimin paraprak të pjesës së ngelur të kredisë të marrë më herët tek “Societe Generale Albania”²²;
- vi. Bashkëshorti i subjektit ka kryer dy pagesa në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. përkatësisht më datë 23.11.2015 shumën 2.500 euro dhe më datë 07.12.2015 shumën 2.638 euro.
- vii. Analiza për vitin 2015 si më poshtë:

	Viti 2015
PASURI	707 246
Apartament me sipërfaqe 51.9 m ² në Komunën ***	707 246
Ndryshim likuiditeti ²³	- 294 948
DETYRIME ²⁴	- 810 543
Kredi bankare në “Societe Generale Albania” për apartament	-455.064
Kredi bankare në “Societe Generale Albania” për makinë	-355.478

¹⁹ Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë e regjistruar ende në pronësi të subjektit.

²⁰ Sipas deklaramit të vitit 2015;

²¹ Shuma e kredisë ka qenë 9,334,800 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.02.2016.

²² Bëhet fjalë për shumën prej 6,492,400 lekë. Për sa më lart, veç sa ka deklaruar në DPV 2016, subjekti ka dhënë edhe shpjegime të detajuara në pyetësorin nr. 2 datë 21.02.2019.

²³ Ndryshon gjendja në banka nga -226 330 lekë në -521 277 lekë.

²⁴ Pagesa për kreditë bankare përkatësisht -455 064 për kredinë hipotekore për blerje apartamenti dhe -355 478 për kredinë për blerje makine.

PASURI NETO²⁵	1 222 841
TE ARDHURA²⁶	2 410 889
Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara	1.236.804
Të ardhura nga paga bashkëshorti të dokumentuara	865.440
Të ardhura nga aktiviteti privat	308.645
SHPENZIME²⁷	1 506 053
Shpenzime jetese	897.104
Interesa kredie	416.652
Shpenzime udhëtimi	192.297
Bilanci sipas analizës së dokumentuar ²⁸	- 318.005
Cash në lekë	580 00029
Cash në Euro	18.000

Sipas analizës së kryer nga njësia e shërbimit ligjor, rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të kryer pagesën e plotë pranë shoqërisë “****” sh.p.k., pasi del një vlerë negative prej 318.005 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Lidhur me situatën financiare me vlerë negative subjekti ka sqaruar sa më poshtë:

I. Të ardhurat nga qiraja e objektit magazinë/dyqan në Fier janë deklaruar rregullisht prej meje në DPV 2015, si edhe në deklaratën “Vetting”, në shumën 264.000 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë, ato burojnë nga marrdhënia e qirasë e dokumentuar nëpërmjet kontratave përkatëse. Në analizën financiare të Komisionit, (shënimi fundor nr. 29), konkludon se: Të ardhurat nga qiraja në vlerën 264.000 lekë nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme për shkak se subjekti nuk provon të ketë paguar tatimin mbi të ardhurat nga qiraja.

Në vijim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti ka sqaruar se ai është i pabazuar në provat dhe faktet konkrete, si dhe legjislacionin tatimor në fuqi, pasi:

- a) Në kontratën e qirasë me z. P. D.,
- nenin 1, parashikon se qiradhënësi e jep dyqanin për destinacionin si *lokal*;

²⁵ Pasuri neto=pasuri+ndryshim likujditeti-detyrim.

²⁶ Të ardhura nga biznesi “****” sipas dokumenteve 308 645 lekë; paga subjekti nga vërtetimet e punësimit 1 236 804 lekë; paga bashkëshorti i subjektit nga vërtetimet e punësimit 865 440 lekë.

²⁷ Interesa kredie 416 652 lekë; shpenzime jetese 897 104 lekë (sipas përlllogaritjeve të INSTAT-it dhe ILDKPKI-së; shpenzime udhëtimi 192 297 lekë.

²⁸ Analiza dokumentuar =të ardhura- pasuri neto-shpenzime

²⁹ Nuk ka ndryshim nga viti paraardhës, për rrjedhojë nuk ndikon në analizë.

- Në nenin 4, të titulluar “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” është parashikuar se: “Qiramarrësi merr përsipër të paguajë vet tatimin mbi qiranë për këtë dyqan”;
- Në nenin 3, të titulluar “Qiraja dhe mënyra e pagesës” është parashikuar se: “Qiramarrësi do t’i paguajë qiradhënësit qiranë në shumën 16.000 lek në muaj, në çdo datë 15 të çdo muaji”.

b) Po ashtu, edhe në kontratën e qirasë me z. L.S., ka të njëjtat parashikime, përveç çmimit të qirasë, i cili do të ishte 6.000 lekë në muaj.

- Në nenin 4, të titulluar “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” është parashikuar se: “Qiramarrësi merr përsipër të paguajë vetë tatimin mbi qiranë për këtë dyqan”.

Nisur nga këto parashikime kontraktore në kontratat e qirasë, të cilat janë administruar si provë, rezulton se palët kanë rënë dakord se detyrimi ligjor për të paguar tatimin mbi të ardhurat, mbi shumat e çmimit mujor të qirasë, do të jetë në ngarkim të palës qiramarrëse, e cila ushtron aktivitet tregtar. Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar që këto të ardhura të konsiderohen të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare.

Në parashikimet e ligjit nr. 8841, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, është përcaktuar se: “Qiramarrësi person fizik/tregtar, paguan tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor si një tatim përfundimtar”.

Sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ndryshuar, detyrimi/ e drejta për të paguar tatimin mbi qiranë, iu kalua qiramarrësit dhe u cilësua si tatim në burim, duke derdhur sipas formularit tip të miratuar nga Tatimet, tatimin në burim.

Vlera e qirasë së përfituar dhe të shënuar në kontratë ishte vlera neto, pasi vetë palët me vullnetin e tyre të lirë e kishin parashikuar këtë në marrëveshje. Subjekti ka pretenduar se ka patur bindjen se qiramarrësit kanë qenë korrekt në likuidimet ndaj tatimeve dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore, duke qenë se nuk ka patur asnjë arsye për të dyshuar për të kundërtën.

Subjekti ka sqaruar se, vetëm pasi është njohur me këtë rezultat, bashkëshorti i saj, është interesuar pranë zyrës së tatimeve Fier, mbi derdhjen e tatimit në burim nga qiramarrësit dhe ka marrë përgjigjen: “*Nuk mund t’ju përgjigjemi, për aq sa nuk keni prokurë nga shtetasi P.D. ose L.S.*”. Subjekti ka pretenduar se nuk duhet të penalizohet për mosveprimin e personave për të cilët nuk mban asnjë përgjegjësi, si edhe për mosushtrimin e detyrave nga inspektorët e tatimeve.

Në shkresën nr. *** prot, datë 03.08.2017 të Drejtorisë së Tatimeve, Tiranë, e administruar në dosje me objekt kthim përgjigjeje, theksohet se: “Në lidhje me të ardhurat nga qiraja, bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33, “*kjo e ardhur tatohet në burim, pra subjekti që e ka marrë me qira.*”

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale, si dhe pagesën e kryer për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ajo ka sqaruar se ka qenë tërësisht në kushtet e padijenisë lidhur me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat, duke e konsideruar këtë fakt si detyrim të qiramarrësve, pasi ata kanë përfituar realisht vetëm të ardhurat neto.

II. Subjekti ka kundërshtuar, llogaritjet e Komisionit për shpenzimet për udhëtime në vitin 2015. Në mbështetje të parashtrimeve, ajo ka paraqitur këto prova:

- Pagesat me kartë krediti për biletat Milano, shkurt 2015;
- Deklaratë E. T. për udhëtimin shkurt 2015, dhe maj 2016 shoqëruar me kartën e identitetit dhe deklarimin e të ardhurave;
- *Statement* bankar për pagesën e qëndrimit në hotel “***”, mars 2015.

a) Për udhëtimin në muajin shkurt të vitit 2015, ka deklaruar dhe vërtetuar se për të janë paguar vetëm shpenzimet e udhëtimit biletat e blera sipas kartës së kreditit në vlerën 15905 lekë + 19585 lekë + 19585 lekë – *statement* i bankës = 55,075 lekë.

Qëndrimi në Milano ka qenë pranë shtetases E. T. – (vajza e dajës), për të cilën ka bashkëlidhur edhe një deklaratë të lëshuar prej saj shoqëruar me kartën e identitetit edhe deklaratën e të ardhurave.

b) Për sa i përket udhëtimit tjetër në Budva, mars 2015, ka sqaruar se edhe ky udhëtim dhe qëndrim është paguar i plotë me kartë krediti vërtetuar –me pagesën sipas *statement*. Subjekti ka theksuar se janë ofertat në mars, përpara nisjes së sezonit turistik, dhe çmimi është *all inclusive*; ndërsa për vajzën e vogël nën 2 vjeç nuk është paguar as biletë avioni dhe as nuk konsiderohet me pagesë në hotel.

Udhëtimi në Budva, hoteli në muajin mars të vitit 2015 ka kushtuar 23.096 lekë, i cili ishte shërbim *all inclusive* për 2 netë qëndrimi (referuar *statement* të bankës : *Weekend All Inclusive në Budva, 2 Ditë €39*)

c) Udhëtim i bashkëshortit në 10.12.2015 - 13.12.2015. Bileta 11,548 lekë – shiko *statement*-in e bankës nëntor 2015.

Shumat e shpenzuara për këto udhëtime janë 131,131.0 lekë.

III. Detyrimet dhe interesat e paguara për kreditë gjatë vitit 2015, subjekti ka shpjeguar se vlera e llogaritur nga Komisioni për detyrimet rezulton të jetë e gabuar, me një tepricë prej 99.711 lekë.

Viti 2015 Interes + Principal i paguar					
Kredia	Për automjet		Për apartament		
Muaj	Interes 1	Principal 2	Interes 3		Principal 4
Jan-15	€ 34.87	€ 180.40	ALL	32,386.00	ALL 31,735.00
Feb-15	€ 33.80	€ 181.47	ALL	32,236.00	ALL 31,885.00
Mar-15	€ 29.57	€ 185.70	ALL	28,981.00	ALL 35,141.00
Apr-15	€ 31.64	€ 183.63	ALL	31,920.00	ALL 32,202.00
May-15	€ 29.57	€ 185.70	ALL	30,515.00	ALL 33,465.00
Jun-15	€ 29.46	€ 185.81	ALL	31,375.00	ALL 32,605.00
Jul-15	€ 26.38	€ 188.29	ALL	30,215.00	ALL 33,765.00
Aug-15	€ 26.19	€ 188.48	ALL	31,064.00	ALL 32,916.00
Sep-15	€ 25.12	€ 189.55	ALL	30,909.00	ALL 33,071.00
Oct-15	€ 23.27	€ 191.40	ALL	29,762.00	ALL 34,218.00
Nov-15	€ 22.97	€ 191.70	ALL	30,594.00	ALL 33,386.00

Dec-15	€ 21.17	€ 193.50	ALL 29,456.00	ALL 34,524.00
Shuma	€ 334.01	€ 2,245.63	ALL 369,413.00	ALL 398,913.00
Interes i paguar		1+3	lekë	415,807.0
Principal i paguar		2	lekë	311,918.0
Principal i paguar		4	lekë	398,913.0

Më poshtë analiza për vitin 2015

N r	Emërtimi të dhënave	Vlerat sipas KPK-së	Vlerat sipas subjektit	Diferenca
1	Pasuri	707,246.0	707,246.0	0.0
a	Porositur apartament me sipërfaqe 51 m ² në Durrës, Komuna ***, ***, kësti I	707,246.0	707,246.0	0.0
2	Të ardhura	2,410,889.0	2,675,889.0	(265,000.0)
a	Të ardhura subjekti nga paga të dokumentuara	1,236,804.0	1,236,804.0	0.0
b	Të ardhura bashkëshorti nga paga të dokumentuara	865,440.0	865,440.0	0.0
c	Të ardhura nga biznesi “****” bashkëshorti i subjektit	308,645.0	308,645.0	0.0
d	Të ardhura nga qiratë		265,000.0	(265,000.0)
3	Detyrime	-810,542.0	-710,831.0	(99,711.0)
a	Detyrim kredia bankare “Societe Generale Albania” për apartament	-455,064.0	-398,913.0	(56,151.0)
b	Detyrim kredia bankare “Societe Generale Albania” për blerje mjete	-355,478.0	-311,918.0	(43,560.0)
4	Shpenzime	1,505,401.0	1,193,130.0	312,271.0
a	Shpenzime jetese	897,104.0	646,192.0	250,912.0
b	Pagesa me kartë krediti mbi shpenzimet e jetesës	0.0		0.0

c	Interesa kredie	416,000.0	415,807.0	193.0
d	Shpenzime udhëtimi	192,297.0	131,131.0	61,166.0
5	Ndryshim likujditeti në fund të vitit	-294,947.0	-333,721.2	38,774.2
a	Ndryshim likujditete (gjendja <i>cash</i> e deklaruar dhe gjendja e llogarive bankare në fund të vitit	-294,947.0	-333,721.2	38,774.2
6	Diferenca (2+3-1-4-5)	-317,353.0	398,403.2	(715,756.2)

	Progresive	- 1,963,244.0	4,336,402.8	(6,299,646.8)
--	------------	------------------	-------------	---------------

Nga, konkluzioni i analizës financiare për vitin 2015, vlera +398,403.2 lekë duhet të përfshihet në analizën financiare të Komisionit, nga e cila rezulton e provuar se të ardhura e ligjshme në vitin 2015 kanë qenë të mjaftueshme për të kryer pagesën e kështit të parë dhe të dytë në shumën prej 318.005 lekë, për pasurinë e trajtuar në këtë pikë.

Vlerësimi i Komisionit

- i. Pasi janë analizuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ato që janë vlerësuar të plota dhe bindëse, janë përditësuar në analizën financiare të vitit 2015, nga e cila, si përfundim ka rezultuar se subjekti nuk gjendet në mangësi të burimeve financiare për të kryer pagesat për blerjen e pasurisë në objekt vlerësimi.
- ii. Modifikimet e analizës kanë konsistuar, në përditësimin e disa shpenzimeve të udhëtimeve sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekti, në marrjen në konsideratë të burimit të të ardhurave nga qiraja e pasurisë në Fier, nga momenti që subjekti, jo vetëm paraqiti dokumentacion provues mbi pagesat e tatimeve për këto të ardhura, por shpjegoi bindshëm lidhur me situatën e krijuar;
- iii. Lidhur me këtë çështje Komisioni ka vlerësuar si rrethana lehtësuese faktet që: (i) sendi i dhënë me qira ishte dyqan, pra, njësi me përdorim për aktivitet tregtar; (ii) kontrata e qirasë parashikonte qartësisht detyrimin e palës qiramarrëse për të paguar tatimet mbi të ardhurat nga qiraja – rrethanë e parashikuar edhe nga dispozitat ligjore; (iii) nënshkruesi i kontratës, si palë qiradhënëse ka qenë bashkëshorti i subjektit; (iv) shumat e përfituara nga subjekti konsideroheshin neto.
- iv. Në rastin konkret, Komisioni vlerëson se të ardhurat nga qiraja e pasurisë magazinë/dyqan në Fier janë deklaruar rregullisht (në vlerën neto) nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën vjetore periodike të 2015, si edhe në deklaratën “Vetting”, në shumën 264.000 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë dhe ato provoheshin nëpërmjet kontratave përkatëse të qirasë. Në bazë të kontratës, palët kanë parashikuar me vullnet të lirë se pagimi i detyrimit tatimor mbi qiranë për këtë pasuri do të bëhej nga qiramarrësi dhe se ky përcaktim vinte edhe në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.
- v. Në të tilla rrethana, Komisioni vlerëson se nisur nga kontrata e qirasë, detyrimin e pagesës e kishte qiramarrësi, i cili në vijim i jepte qiradhënësit vetëm çmimin neto të qirasë. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte i bindur se ky detyrim ishte përmbushur, ndaj nuk mund t’i atribuohet atij ndonjë përgjegjësi për shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat. Subjekti i rivlerësimit ka provuar

bindshëm këtë marrëdhënie mes palëve qiradhënëse dhe pas verifikimeve të kryera, ajo ka kryer pagimin e detyrimit tatimor përkatës si dhe gjobën. Vetë ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë, por për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga vetë organi tatimor.

3.1 Mbështetur në analizën e shpjeguar më sipër, Komisioni konkludon se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e kësaj pasurie, si dhe ka patur mundësitë financiare nga burime të ligjshme për kryerjen e një shpenzimi të tillë.

4. Autoveturë Peugeot 308 SW, prodhuar në vitin 2010, blerë në vlerën prej 15,550 euro, në vitin 2012

- i. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën “Vetting”, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me pjesë takuese 50%, me burimi i krijimi pjesërisht, 4070 euro nga vlerësimi i mjetit (Peugeot 206), të dhënë mbrapsht tek shitësi, dhe pjesa tjetër prej 10.850 euro nga kredia bankare;
- ii. Nga akti i shitjes së autoveturës Peugeot 206, rezultoi se çmimi real i shitjes ishte 2,480 euro, dhe jo 4,070 euro, sa kishte pohuar subjekti;
- iii. Në vijim, subjekti është pyetur në pyetësorin nr. 3, datë 29.03.2019, në lidhje me blerjen e këtij automjeti dhe ka sqaruar se shuma prej 2,480 euro me të cilën shoqëria “****” sh.p.k. ka blerë automjetin nga shoqëria “Raiffeisen Leasing” është paguar nga ana jonë dhe është mbyllur detyrimi leasing, pasi kishim rënë dakord që kjo shoqëri të vlerësonte mjetin në vlerën 4,070 euro. Vlerë e cila është marrë në konsideratë në blerjen e mjetit të ri – Peugeot 308.³⁰

4.1 Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie, pasi ato janë mbuluar me të ardhura të ligjshme dhe as me deklarinimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, të cilat janë kryer saktë. Nga të gjitha rrethanat e faktit dhe nga hetimi administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie, pasi provat e analizuar dhe dokumentet e administruara provojnë bindshëm krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme. Nga hetimi administrativ nuk rezultuan pasaktësi apo fshehje të aseteve në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, për rivlerësimin të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

5. Apartament me sipërfaqe 138 m², në rr. “**”, Tiranë, në përdorim të subjektit, prej vitit 2010, pa kundërshpërblim**

- i. Subjekti e ka deklaruar si adresë banimi për herë të parë në deklaratën vjetore 2012, e në vijim deri në vitin 2018;
- ii. Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron për herë të parë përdorimin (mbajtjen) e apartamentit në fjalë, pronësinë e tij, si dhe faktin që ajo dhe familja e saj e kishin në përdorim këtë apartament prej vitit 2010, pa kundërshpërblim – duke iu referuar deklaratës noteriale të datës 18.10.2016;
- iii. Nga akti i akomodimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016 rezulton se apartamenti në fjalë është në pronësi të shtetasit R. A., i cili deklaron se sendin me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, sipërfaqe 138 m², ndodhur në Rr. “****”, pallati nr. ***, pranë mobilieri “****”, e

³⁰ Nga vlera prej 15,550 euro e çmimit të blerjes së këtij mjeti, 4,070 është vlerësuar mjeti i vjetër që ishte në posedim të subjektit dhe bashkëshortit, dhe që i është dorëzuar shitësit. Ndërsa shuma prej 2,480 euro është paguar nga kursimet e subjektit për të mbuluar detyrimin me shoqërinë “Raiffeisen Leasing”.

ka dhënë në përdorim, me qëllim banimi dhe pa kundërshtëpërblim, prej vitit 2010, dhe pa afat mbarimi, bashkëshortit të subjektit dhe familjes së tyre;

- iv. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2010, subjekti në rubrikën e adresave ka deklaruar si adresë banimi, njësia nr. *** “***”, Tiranë. Kjo adresë nuk rezulton që të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe as marrëdhënia juridike që subjekti ka pasur me këtë adresë banimi të deklaruar.
- v. Adresa e banimit të apartamentit në Rr. “***”, Tiranë, nuk rezulton që të jetë deklaruar në deklaratat e interesave private 2010 dhe 2011. Siç u tha edhe më lart, për herë të parë kjo adresë deklarohet në deklaratën e interesave private të vitit 2012, ndërkohë që shtetasi R. A., si edhe vetë subjekti në deklaratën “Vetting”, deklarojnë akomodimin e tyre që nga viti 2010 në këtë banesë;
- vi. Pasi është pyetur, subjekti ka deklaruar se pronar i këtij apartamenti ku banon familja e saj është z. R. A., punëdhënës i bashkëshortit të saj;
- vii. Në këtë pasuri/banesë – sipas subjektit - familja e saj është akomoduar prej vitit 2010, sipas deklaratës noteriale “Aktakomodimi”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2016;
- viii. Lidhur me dhënien në përdorim pa kompensim të kësaj pasurie është pyetur z. R. A., i cili ka pohuar se është i vërtetë fakti i paraqitur/deklaruar nga subjekti, pasi ai i ka lënë në përdorim pa kompensim bashkëshortit të subjektit një apartament që e kishte për djalin e tij, dhe shkaku i këtij veprimi ka qenë marrëdhënia e punësimit, pasi z. Alicanaj ka punuar si inxhinier/drejtues teknik, për shoqërinë e tij “***” sh.p.k, dhe pasi ky i fundit është larguar nga ky vend pune, pas pak javësh ka dorëzuar edhe apartamentin në fjalë.
- ix. Nga hetimi, Komisioni vlerësoi se, sa më lart duket se përbën një trajtim preferencial që duhej të ishte deklaruar si i tillë në rubrikat përkatëse të deklaratave vjetore, prej vitit 2013 e në vijim, gjë që nuk rezulton të jetë bërë nga subjekti.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- x. Subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“kjo adresë është deklaruar për herë të parë në DPV e vitit 2012, por kjo ka ardhur për arsyen se, vendbanimi dhe vendqëndrimi im, për shkak të punës kanë qenë të ndryshëm. Me qëllim që të garantoja qartësinë dhe sigurinë e vendqëndrimit tim, unë dhe vajza ime, për shkak se isha e punësuar në Zyrën Vendore të Avokaturës së Shtetit në Vlorë (shih dokumentacionin bashkëlidhur dhe deklarinimin e këtij pozicioni pune), kemi qëndruar dhe jetuar, tek prindërit e mi në qytetin e Fierit, ndërsa bashkëshorti nga shtëpia në *** ishte zhvendosur në apartamentin e dhënë në përdorim nga punëdhënësi i tij. Për të respektuar me përpikëri ligjin, unë i qëndrova besnike adresës së zyrës së gjendjes civile, në të cilën jam regjistruar dhe kam deklaruar vendbanimin. Në deklaratën vjetore pasardhëse të vitit 2012, pasi vendbanimi dhe vendqëndrimi im dhe i familjes sime ishte i stabilizuar, unë e kam deklaruar menjëherë këtë adresë, duke siguruar përputhshmërinë e gjendjes faktike të banimit me atë juridike. Shpjegoj se kjo është bërë për të siguruar kontaktimin, njoftimin dhe gjatshmërinë e sigurt të anëtarëve të familjes time.”*
- xi. Sipas subjektit, përdorimi i këtij apartamenti, nuk mund të konsiderohet si trajtim preferencial, dhe nuk përbën deklarinim të rremë për arsyet si më poshtë:
“Përfundimi i arritur nga ana e trupit gjykues sipas të cilit, unë nuk kam deklaruar banimin në pronën e tjetër kujt si trajtim preferencial nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj. Sa i përket faktit, rezulton katërcipërisht e provuar se banimi në pronën e tjetër kujt, nuk më është dhënë mua, por bashkëshortit dhe përbën një shpërblim në natyrë për shkak të punës si inxhinier dhe drejtues teknik i shoqërisë.

Përdorimi i banesës në pronësi të shoqërisë jepej si kompensim për shkak të vënies së tij në disponibilitet të shoqërisë ku ai kryente punën. (*shih në cilësinë e provës dokumentare dëshminë e z. R. A.*).

Në të tilla rrethana fakti, rezulton e provuar dhe e pa vënë në diskutim se mbajtja e sendit për banim është dhënë për shkak të “detyrës të bashkëshortit” dhe jo për shkak të ushtrimit të funksionit tim, si ndihmëse ligjore. Kjo do të thotë se mungon ‘lidhja shkakësore’ e dhënies së sendit në pronësi të tjetërkujt për banim dhe funksionit të subjektit të rivlerësimit. Pra, sendi nuk i është dhënë bashkëshortit tim për shkak të funksionit që unë kryeja. Rrjedhimisht nuk ndodhemi përpara një trajtimi preferencial.

Trajtimi preferencial sipas nenit 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, titulluar “Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale”, parashikohet si: “*1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji.*”. Sipas këtij përcaktimi ligjor, trajtim preferencial është ai që jepet për shkak të pozicionit të zyrtarit!

Kjo do të thotë se shkak i përfitimit është lidhja e trajtimit me detyrën e zyrtarit. Në rastin konkret, kjo lidhje e domosdoshme nuk ekziston, pasi trajtimi është dhënë për shkak të detyrës së bashkëshortit tim dhe jo për shkak të cilësisë sime. Ky element cilësues, mungon në rastin konkret dhe për këtë shkak ligjor, nuk ndodhemi përpara një trajtimi preferencial për shkak të detyrës sime. Detyra ime nuk përbën shkak dhe nuk ka ndikuar fare në marrëdhënien e punës që ka bashkëshorti im me shoqërinë private që vepron në fushën e ndërtimit.

- xii. Nga interpretimi i normës rrjedh e ajo nuk është e zbatueshme për mua në rastin konkret, dhe nuk mund të më atribuohet ndonjë përgjegjësi për mbajtjen e banesës për shkaqe të kontratës individuale të punës së bashkëshortit.

Duke qenë se përfitimi është i lidhur me punën që kryen bashkëshorti dhe përbën një kompensim për shkak të disponibilitetit që punëdhënësi ka ofruar orar pa orar, mbajtja e banesës për shkaqe të kontratës individuale të punës së bashkëshortit nuk mund të cilësohet kurrsesi një trajtim preferencial që ka lidhje me mua.

Edhe sikur për një çast të merret e mirëqenë, që mbajtja e banesës për shkaqe të kontratës individuale të punës së bashkëshortit, do të konsiderohet si një trajtim preferencial për mua, ky deklaram është bërë në rubrikën e deklaramit të adresës. Vlera e këtij trajtimi është zero, dhe deklarami në seksionin e gabuar të deklaramit të pasurisë nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe nuk mund të konsiderohet si element pasaktësie, pamjaftueshmërie, apo deklaram i rremë, dhe rrjedhimisht të kërkojë marrjen e masave dhe atribuimin e përgjegjësisë ndaj meje, sipas ligjit për Vettingun.

Për më tepër, referojuni dëshmisë së z. R. A. përpara Komisionit më datë 28.05.2019, faqe nr. 3, i cili sqaron se cila ishte arsyeja e dhënies pa kundërshtpërblim të këtij sendi, apo e mosshitjes dhe mosdhënies me qira. Arsyeja është “*marrëdhënia e punës që kishin A. A. dhe R.A.*”. Kjo banesë është pjesë e kontratës së punësimit të bashkëshortit tim, siç ishte edhe fatura e telefonit, apo konsumi i karburantit, politikë e shoqërisë ku punonte.

Që apartamenti ishte pjesë e kontratës së punës së bashkëshortit tim, kjo evidentohet edhe nga fakti se menjëherë me përfundimin e marrëdhënies të punës mes palëve ne e kemi dorëzuar apartamentin z. R. A.

Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor nga ku fillon evidentimi i përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit për shkelje disiplinore është deklarata “Vetting” dhe të dhënat që ajo përmban. Të njëjtën vlerë juridike me deklaramtën “Vetting” të pasurisë ka mënyra e përpilimit, si dhe të dhënat

që pasqyrohen për herë të parë në Deklaratën e Figurës (neni Dh). Mospërpilimi i këtyre dy deklaratave sjell përgjegjësi ligjore.”

Vlerësimi i Komisionit

- i. Për sa më lart, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit, të cilat përkojnë edhe me deklaratimet e dhëna, përpara Komisionit, nga z. A., kanë rezultuar bindëse, dhe për rrjedhojë, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet e një trajtimi preferencial dhe për këtë shkak nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar atë. Ky konkluzion mbështetet edhe nga analiza e të gjitha elementeve përbërës të marrëdhënies së bashkëpunimit shumëvjeçar midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërive të z. R. A.. Nga kjo analizë nuk rezulton që të ketë lidhje ndërmjet cilësisë së funksionit të subjektit të rivlerësimit dhe përdorimit të kësaj pasurie.
- ii. Konkluzioni i mësipërm bazohet në faktin se vetë z. A. ka pohuar se shkak për të cilin ai i kishte dhënë në përdorim, pa kundërshtim, apartamentin në fjalë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, lidhej ngushtë me faktin që ky i fundit prej vitesh punonte për shoqëritë e tij si drejtues teknik, dhe se në njëfarë mënyre, kjo kompensonte edhe pagesën e tij. Pra, bëhej fjalë për një balancim të marrëdhënies të veçanta financiaro-profesionale midis tyre, dhe jo për një trajtim favorizues pa shkak që mund të konfirmonte një trajtim preferencial që do të shtrihej mbi të gjithë familjen “përfutuese”, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit;
- iii. Nga sa më lart, Komisioni konkludon se lidhur me këtë pasuri në përdorim, shpjegimet e subjektit dhe faktet e konstatuara konsiderohen të sakta.
- iv. Gjithashtu, Komisioni çmon se nuk vlerësohen të pasakta deklaratimet e viteve 2010 dhe 2011, për mungesën e deklaratimit të adresës së pasurisë së sipërcituar, pasi subjekti ka dhënë shpjegime bindëse që në ato dy vite ajo nuk ka banuar në këtë banesë dhe se banesa e deklaruar ka qenë ajo e gjendjes civile. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, për shkak të emërimit dhe ushtrimit të funksionit të nëpunësit publik, ka ushtruar veprimtarinë e saj jashtë qytetit të Tiranës, dhe aty, në atë periudhë, ka banuar vetëm bashkëshorti i saj.

6.1 Nga hetimi administrativ nuk u rezultuan pasaktësi apo fshehje të aseteve në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, për rivlerësimin kalimtar dhe në bazë të provave dhe shpjegimeve u argumentua në mënyrë bindëse se nuk kemi të bëjmë me praninë dhe mosdeklarimin e një trajtimi preferencial, as edhe me pasaktësi lidhur me deklaratimin e adresës së banimit të subjektit të rivlerësimit.

6. Lidhur me analizën financiare

Në vijim të analizës financiare të kryer nga Komisioni, ishin arritur konkluzionet paraprake të pasqyruara në tabelën që shoqëronte rezultatet e hetimit që i janë komunikuar subjektit. Pas kalimit të barrës së provës për mungesat e burimeve financiare të konstatuara nga hetimi administrativ, subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësime të detajuara dhe shpjegime, si dhe dokumente mbështetëse, lidhur me elementet përbërës dhe përlllogaritjeve të të ardhurave dhe të shpenzimeve të familjes së saj, të cilat kishin prodhuar rezultatet e përshkruara në rezultatet paraprake të hetimit.

Konkretisht, znj. Alicanaj ka kundërshtuar një sërë zërash/elementesh të analizës financiare të Komisionit, duke konstatuar ata si të pasaktë dhe në disa raste jo të plotë. Përpos argumentimeve lidhur me burimin e të ardhurave nga qiraja e njësisë/dyqan, më vendndodhje në Fier, të cilat janë analizuar më lart, kur është analizuar burimi financiar për blerjen e pasurisë në vitin 2015, dhe që shtrijnë efektet, duke neutralizuar mungesën e burimeve financiare edhe për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shpjegimet dhe argumentet e saj, duke depozituar edhe dokumente provues, dhe duke kërkuar sa më poshtë vijon:

a. Në lidhje me të ardhurat nga biznesi “****”, subjekti argumenton se analiza financiare duhet të marrë në konsideratë të ardhurat nga ky aktivitet (për vitet 2009-2011, në vlerën 300.000 lekë për vitin 2009; 600.000 lekë në vitin 2010 dhe 500.000 lekë në vitin 2011), periudhë për të cilën nuk disponohen të dhëna nga DPT-ja pasi, me dokumentacionin dhe vërtetimet e vendosura në dispozicion provohet se ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;

Trupi gjykues e ka pranuar këtë kërkesë. Në rastin konkret gjendemi përballë deklarimeve të fitimeve nga ky biznes që futen në këtë vëllim qarkullimi, dhe për rrjedhojë janë të mbuluara për sa u përket detyrimeve tatimore.

Subjekti ka kërkuar rishikimin e të ardhura nga punësimi për bashkëshortin pranë shoqërive “****” sh.p.k. (shtator 2005 - janar 2006, në vlerën 147.880 lekë) dhe “****” sh.p.k. (prill 2006 - qershor 2007);

Në këtë rast, pretendimi i subjektit nuk është marrë në konsideratë, pasi, pavarësisht sa deklarohet si e ardhur e bashkëshortit, Komisioni ka përlllogaritur shumat e tatuara, dhe që kanë rezultuar nga komunikimi me ISSH-në, si të përfituara prej tij, në periudhat në fjalë.

Subjekti ka kërkuar rishikimin e analizës financiare dhe përfshirjen në të, të ardhurave nga qiraja për objektin/dyqanin e ndodhur në Fier (vitet 2015 dhe 2016 në vlerën 264.000 lekë në vit), duke konsideruar ato si të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore përkatëse. Pas shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit ligjor provues lidhur me këto të ardhura Komisioni ka pranuar ato si të ardhura të ligjshme, duke i përfshirë në analizën financiare, siç u shpjegua dhe më lart.

Subjekti ka kërkuar marrjen në konsideratë si të ardhura, dhuratat e vogla financiare të dhëna nga të afërm me rastin e lindjes së fëmijës (viti 2013 në vlerën 195.000 lekë). Gjithashtu, subjekti për vitin 2013 ka pretenduar zbritjen nga shpenzimet jetike, të disa shumave të shpenzuara me kartë krediti, jo për ushqime, por për blerje pajisjesh për biznesin, dhe tërheqje *cash* për të cilat ka arsyetuar se dukshëm ato janë shpenzime të kryera për biznesin dhe nuk mund të ngarkohen si shpenzime personale, pasi janë pjesë e aktivitetit tregtar të deklaruar;

Komisioni, e konsideron të mundshëm, realizimin e këtyre të ardhurave, bazuar në shpjegimet e subjektit, të justifikuara nga traditat shqiptare, pavarësisht se për këto raste nuk mund të ketë prova konkrete mbi sasinë monetare të përfituar. Komisioni çmon se ato duken bindëse, pasi lidhen me faktin e lindjes së fëmijës, mbulojnë shpenzime ekstra (jashtë shportës) të kryera nga subjekti brenda atij viti kalendarik, si dhe janë në një shumë logjike të pranueshme. Për rrjedhojë, mund të konsiderohet si e neutralizuar edhe mungesa financiare që rezultonte në vitin 2013.

b. Në lidhje me pagimin e kredive (principal dhe interes) subjekti ka kërkuar rishikimin në analizë financiare, për shkak të disa pasaktësive në llogaritje (për periudhën 2010-2016) nga Komisioni.

Lidhur me këtë pikë, nga ana e njësisë së shërbimit ligjor janë konstatuar disa pasaktësi që rezultojnë nga përlllogaritjet e kryera më parë prej saj, subjekti i ka përditësuar ato të dhëna, duke shmangur efektet negative në analizën financiare, pas mbylljes së hetimit administrativ nga Komisioni.

c. Subjekti kundërshton nivelin e shpenzimeve të jetesës për disa vite dhe argumenton që si referencë për këto shpenzime duhet konsideruar shpenzimet me kartën e kreditit të përdorur nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, (për vitin 2014 në vlerën 289.666 lekë dhe vitin 2015 në vlerën 250.912 lekë), dhe jo termat e referencës së institucionit;

Kjo kërkesë nuk është pranuar pasi, Komisioni vëren se në analizën financiare aplikohet një minimum i shpenzimeve jetike, të përlogaritura nga INSTAT dhe që merret si referencë për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

d. Subjekti ka kërkuar që në lidhje me përlogaritjen e shpenzimeve familjare për frymë, të merret në konsideratë momenti i saktë i lindjes së fëmijës së tyre dhe jo për të gjithë vitin, edhe pse në periudhën e parë fëmija ushqehet me qumësht gjiri, dhe nuk kishte shpenzime ushqimi për të;

Lidhur me këtë pikë, nga njësia e shërbimit ligjore është kryer korrigjimi i periudhës së referuar, duke i përlogaritur shpenzimet për frymë në mënyrë proporcionale.

e. Subjekti ka kundërshtuar shpenzimet e përlogaritura në analizën financiare në lidhje me udhëtimet (periudhën para vitit 2010, si dhe periudhën në vitet 2014, 2015), duke sjellë dokumentacion provues për nivelin e këtyre shpenzimeve;

Komisioni ka marrë në konsideratë të gjitha provat e sjella nga subjekti, duke përditësuar ato kosto të parashikuara nga analiza financiare që nuk përkonin me provat e paraqitura nga subjekti.

f. Subjekti ka kërkuar që në rastin kur rezultati financiar i një viti është me gjendje pozitive (tepricë nga viti 2013 në vlerën 129.768 lekë), kjo gjendje të mbartet për vitin tjetër;

Kjo kërkesë e subjektit nuk është marrë në konsideratë, për sa kohë nuk rezulton e deklaruar si gjendje *cash* në banesë, në fund të vitit në fjalë, kursimi i pretenduar, edhe pse nga analiza financiare rezulton se ato shuma, teorikisht, mundej që të kurseheshin, pasi ky fakt mbetet i paprovuar;

Subjekti ka kërkuar marrja në konsideratë e një lapsusi në deklarimin e vitit 2014, kur subjekti shprehet se nuk ka deklaruar uljen e gjendjes *cash* në monedhën euro (4.400 euro);

Ky pretendim i subjektit nuk mund të merret në konsideratë, për shkaqet e përmendura në pikën e mësipërme – edhe pse me kah të kundërt – pasi këtu bëhet fjalë për mosdeklarimin e një pakësimi të gjendjes *cash*. Megjithëse po të merren në konsideratë deklaratimet e subjektit lidhur me të ardhurat e tyre nga tre pagat e bashkëshortit si dhe gjendja e likuiditeteve e rezultuar në vitin pararendës, situata financiare do të rezultonte pozitive, Komisioni nuk disponon ndonjë dokumentacion provues lidhur me disponimin e këtyre të ardhurave.

g. Subjekti ka kërkuar që shuma e papaguar në vijim të marrëdhënies së kontratës së porosisë me shoqërinë “****” sh.p.k. mos të konsiderohet si detyrim i pashlyer, por pjesa e paguar të konsiderohet si një e drejtë e subjektit (vetëm pjesa e paguar 18.335 euro);

Kjo rrethanë është shqyrtuar në lidhje me pasurinë/pikën nr. 3, ku është trajtuar marrëdhënia me shoqërinë ndërtuese në sajë të kontratës së porosisë së datës 25.01.2012 dhe është pranuar nga Komisioni.

h. Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të shumës prej 8.000 euro të depozituara në bankë në vitin 2014, për të cilin Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit. Ka rezultuar se, subjekti ka paraqitur dokumente shkresore, prova dhe shpjegime përkatëse, duke provuar në mënyrë bindëse të kundërtën e rezultatit paraprak të hetimeve. Komisioni vlerëson se nga analiza e deklaratimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personi i lidhur, rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2014 deklarohen disa derdhje në llogarinë bankare në shumën 8.000 euro (lëvizje bankare të specifikuar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj), duke justifikuar me burim financiar nga premtim shitja, midis znj. N. A., dhe z. G. D., si edhe kursime të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij. Kontrata e premtim shitjes rezulton të jetë lidhur në vitin 2010, ndërsa në vitin 2012 është bërë anulimi i këtij veprimi, duke u kthyer mbrapsht nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, shumat e

paguara nga z. D.. Si burim i kthimit mbrapsht, ka shërbyer të ardhurat e bashkëshortit të subjektit dhe të subjektit nga kredia e marrë dhe kursimet e familjare. Pra, jo të ardhurat e N.A., që kishte marrë nga kontrata e premtim shitjes.

Në rastin konkret, sipas deklaramit periodik të vitit 2014, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “lëvizjet në llogari 10.000 (dhjetë mijë) euro të ardhura nga kontrata premtim shitje (viti 2011) e truell 154 m² dhe dyqan i ndërtuar mbi të me sipërfaqe 83.80 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier në emër të znj. N. A), dhe **pjesa tjetër me kursimet e tyre, me qëllim prenotim apartamenti**, i cili nuk u arrit të finalizohet.” Gjithashtu, në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 08.07.2019, znj. N. A. ka deklaruar se, ajo ka nënshkruar një kontratë premtim shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.2010, me palë blerëse G. D.. Në bazë të kësaj kontrate, ajo i ka shitur një pronë me nr. regjistri hipotekor *** kol., vol. ***, faqe ***, datë 02.05.2008, e ndodhur në Fier. Kjo pronë është rënë dakord për t’u shitur për shumën 72.000 euro. Pala blerëse sipas kontratës së shitjes ka paguar shumën prej 30.000 euro në llogarinë e djalit të saj A. A., shumë kjo e përdorur për të mbyllur një ekspozim bankar që djali i saj, kishte pranë një banke të nivelit të dytë, duke afuar si garanci hipotekore pronën objekt shitjeje. Gjithashtu, pala blerëse ka likujduar në datë 17.09.2010 shumën 1,060,000 lekë dhe në datën 02.11.2010 shumën prej 689.500 lekë në llogari të djalit tjetër E. A., të cilat i ka tërhequr dhe ia ka dorëzuar N. A., në *cash*. Pra, pala blerëse në total deri në këtë moment, kishte paguar shumën 42.000 euro. Pala blerëse, duke qenë se u tërhoq nga kontrata e shitjes, sipas deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2012, atëherë znj. N. A. u detyrua t’i premtojë z. G. D. kthimin e shumës 42.000 euro.

Duke qenë se znj. N. A. nga kjo shumë kisha shpenzuar një pjesë të konsiderueshme, atëherë i kërkoi djalit A. A. ta ndihmonte për të kthyer këtë shumë dhe për të kthyer kontratën. Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.04.2012 i janë kthyer z. G. D. si palë blerëse, shuma prej 30.000 euro nga llogaria e djalit të znj. N. A. shtetasi A. A., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndërsa diferenca shuma prej 12.000 euro u mor përsipër të kthehej çdo 3 muaj, po nga djali i znj. N. A., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. A.”

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjerave, dokumentet ligjore, *statement* banke z. G. D. për E. A., si dhe 4 mandate banke të “Societe Generale Albania” nga A. A..

Nga të dhënat e provave dhe dokumentet ligjore, Komisioni konstaton se është provuar qartësisht se bashkëshorti i subjektit ka krijuar marrëdhënie juridike me z. G. D. në prill të vitit 2012, si dhe e ëma e tij, znj. N. A. kishte një pjesë të pagesave të marra më parë prej tij. Nga deklarata noteriale znj. N. A. dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, si dhe nga lëvizjet bankare e mësipërme rezulton se znj. N. A. nga parapagimi i kontratës së shitjes kishte ende kursime të shumës 12.000 euro, ndërsa **kthimi pas i kësaj vlere është bërë tërësisht nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe burim shlyerje është kredia e marrë në “Societe Generale Albania” dhe kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të saj të lidhur.** Nga hetimi i Komisionit rezulton se znj.N. A. kishte ende të ardhura nga paragimi i kontratës, pasi **ajo nuk i ktheu ndonjëherë.** Gjithashtu, edhe subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj provohet, pa asnjë dyshim se kishin **gjendje cash në shtëpi, siç rezulton edhe nga analiza financiare e sipërcituar.**

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se në bazë të dokumentacionit ligjor dhe shpjegimeve të paraqitura, burimi i shumës prej 8.000 euro është i ligjshëm dhe lëvizjet e subjektit të rivlerësimit në llogari janë të qarta, transparente, duke përkuar me shpjegimet e saj dhe me dokumentet shkresore, mandatpagesat, duke përjashtuar çdo dyshim mbi ligjshmërinë e kësaj pasurie. Më konkretisht, në mandatin e Bankës “Societe Generale Albania” datë 30.07.2014, ku është derdhur shuma 9.000 euro **është përshkruar burimi i këtyre të ardhurave: “depozituar nga kursimet”** Në mandatin e “Societe Generale Albania” datë 28.08.2014, është tërhequr shuma 8.000 euro. Po ashtu, edhe në mandatin e Bankës

“Societe Generale Albania”, datë 03.10.2014, është rideozitur kjo shumë, dhe punonjësi i bankës në mandat e ka dokumentuar qartësisht veprimin si: “tërhequr pranë bankës sonë”. Në datë 14.11.2014 është tërhequr shuma 8.600 euro.

Në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie Komisioni vlerëson se provat e paraqitura dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë arritur nivelin e kërkuar të provueshmërisë dhe besueshmërisë. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe ata të tjerë të lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë objekt hetimi nga të ardhura të realizuara në mënyrë të ligjshme.

Në përfundim, Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet shpjeguese, si më lart, si dhe pasi u njoh me rezultatin përfundimtar të analizës financiare, të përgatitur nga njësia e shërbimit ligjor, e cila ka kryer disa korrigjime të pasaktësive të mëparshme, si dhe ka marrë në konsideratë, duke i përllogaritur aty, ndryshimet e disa elementeve të reja, të cilat në vijim të shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, u konsideruan të bazuara, konstatoi se mungesa e burimeve të ligjshme financiare, për gjithë periudhën kohore të rivlerësimit të subjektit, sipas nenit “D” të Kushtetutës, ka rezultuar në shumën prej 1.170.217 lekë, e pashoqëruar nga qëllimi për të bërë deklaram të pasaktë, apo deklaram të rremë, dhe në mungesë të fakteve apo rrethanave që lidhen me funksionin e subjektit të rivlerësimit, apo me konfliktin e interesit.

7.1 Komisioni vlerëson se nuk rezulton e provuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm në lidhje me burimet financiare të përdorura për krijimin e pasurive, për shpenzimet apo për kursimet e deklaruara.

Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se bilanci përfundimtar, i konstatuar në vlerën negative prej 1.170.217 lekë, në këtë rast - duke patur parasysh edhe funksionin e mbuluar në të kaluarën profesionale nga subjekti, - në vetvete dhe në tërësinë e fakteve dhe rrethanave, nuk vlerësohet shkak i mjaftueshëm që të pasjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi përse i përket përllogaritjeve dhe rezultateve financiare, - të cilat kryhen nëpërmjet një analize të thelluar, strikte dhe gjithëpërfshirëse, - ato duhet të vlerësohen në harmoni me kuadrin e plotë të rrethanave dhe provave të arritura, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Balanca financiare negative është e ulët në raport me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera ndër vite dhe subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë kryer fshehje pasurie; nuk ka kryer deklaram të rremë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Në këto kushte, çmohet se kjo mangësi financiare, nuk mund të jetë kusht i mjaftueshëm për dhënien e një mase disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, nëse kjo mungesë nuk shoqërohet edhe me elemente të tjerë plotësuese, që mund të lidhen me deklarameve të pavërteta, të pamjaftueshme, kontradiktore apo jo në përputhje me faktet, ose me arsye që ndërthuren me kriteret e tjera të rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, Komisioni çmoi se për shkak të peshës së ulët specifike, në raport dhe në proporcion me të gjitha faktet, rrethanat dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë kriter të vlerësimit, situata financiare negative e konstatuar si e vetmja problematikë nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Në këtë vlerësim trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë faktin se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë qenë në disa raste edhe më të larta nga ato të llogaritura dhe pranuar nga Komisioni, por se për efekt të pagimit të tatimeve ato nuk janë marrë në konsideratë. Po ashtu trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë në këtë vlerësim gabime të mundshme që mund të konsiderohen në analizën financiare, jetesën dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj, të cilat nuk japin të dhëna për një jetesë luksoze, si dhe pozicionin e punës së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka përcjellë një raport për subjektin e rivlerësimit, të datës 30.10.2017, me nr. *** prot., në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit;

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;

Komisioni gjatë hetimit administrativ nuk konstatoi asnjë gjetje që mund të vinte në dyshim konkluzionet e DSIK-së pasi, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë çmohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Sipas pikës 2, të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollën e Magjistraturës.

a) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka përcjellë me shkresën nr. ***, datë 01.10.2018 “Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Maela Alicanaj për periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016”.

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumentave ligjorë të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe ato të përzgjedhura me short e të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën I dhe II të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3, dokumenti 4, dokumenti 5, dokumenti 6, dokumenti 7 dhe dokumenti 8”.

Nga analiza e 8 dokumenteve ligjore të përzgjedhura konstatohet se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në procese pune që lidhen me shqyrtimin e çështjeve penale nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Tetë dokumentet ligjore tregojnë se ajo ka pasur mundësinë të përfshihet në çështje që lidhen me të drejtën penale dhe të drejtën procedurale penale, që lidhen qoftë me lloje të ndryshme të veprave penale, qoftë me rregullat e përgjithshme materiale penale apo qoftë edhe me çështje të ndryshme procedurale.

3 dokumentat ligjorë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Maela Alicanaj janë të shkruar qartë në mënyrë të kuptueshme dhe strukturuar. Edhe në 5 relacionet e vëzhguara të përzgjedhura me short është ruajtur një strukturë arsyetimi.

Nga 5 dokumentat e përzgjedhur me short, në 5 raste rezulton se mendimi i ndihmësit ligjor është i përfshirë në dosjet fizike përkatëse. Nga ana tjetër, duhet theksuar se asnjë prej dokumentave të paraqitur dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

Ndihmësja ligjore Maela Alicanaj ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 09.07.2002 dhe titullin “Master i Nivelit të Dytë” nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, në fushën Administrim Publik në vitin 2009. Pas studimeve, në korrik 2011, është emëruar në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë. Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë, kjo edhe për shkak të natyrës së punës.

b) Rezultatet e testimit pranë shkollës së Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr.485 prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetues dhe sipas parashikimeve të nenit 42, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rezulton se, me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës nr. 17, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7-8 maj të vitit 2018.

Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit znj. Maela Alicanaj ka marrë mbi 60% të pikëve të mundshme, duke e kapërcyer pragun e kualifikimit, dhe po ashtu në fazën e dytë ka rezultuar fituese për regjistrimin e saj në Shkollën e Magjistraturës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës konfirmon se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit znj. Maela Alicanaj bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60% të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjekë programin dyvjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

Denoncimet nga publiku

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk janë paraqitur denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit ligjor të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale si vijon: *“Gjykimi në Gjykatën e Lartë ka qenë dhe mbetet i posaçëm dhe ndryshonte nga gjykimi i gjykatave të themelit të shkallës së parë dhe të apelit. Kjo do të thotë se natyra e gjykimit dhe mënyra e funksionimit të Gjykatës së Lartë, është e ndryshme nga shkallët e tjera të gjykimit. Për më tepër, çka është e rëndësishme, Gjykata e Lartë ka pasur një autonomi të gjerë funksionimi dhe rregullimi, për rrjedhojë edhe natyra e punës dhe detyrat e ndihmësit ligjor kanë qenë të ndryshme. Objektivat dhe mënyra e përgatitjes së relacionit vareshin nga secili gjyqtar relator dhe kushtet të tjera, siç janë urgjenca e gjykimit dhe numri i lartë i çështjeve, kështu, për ilustrim gjykimet me objekt masat e sigurimit nuk parashikon dhënien e mendimit me shkrim.*

Qëllim kryesor i përgatitjes së relacionit nga ndihmësi ligjor është pasqyrimi i përmbajtjes së fashikullit penal në mënyrë të përmbledhur dhe koncize. Me qëllim kontrollin e ligjshmërisë së vendimmarrjes së gjykatave të themelit dhe dallimin e kontrollit të ligjshmërisë nga kontrolli i themelit në Gjykatën e Lartë ishte tepër e rëndësishme, evidentimi i rrethanave të çështjes, mënyrës së

vendimmarrjes së gjykatave dhe tregimin e pretendimeve të palëve, pa këto elemente analiza ligjore, do të ishte thuajse e pamundur dhe shterpë, sepse nuk do të mund të lidhej me zbatimin e ligjit material apo atij procedural në rastin konkret. Përgatitja e relacionit nga ana e ndihmësit i shërbente këtij qëllimi.

Gjetjet e trupit gjykues të KPK-së, lidhur me komponentin profesional, nuk lidhen me aftësitë profesionale dhe personale të miat, pasi në thelb, shkaqet e tyre lidhen me nivelin dhe përmbajtjen e pretendimeve dhe nivelin e tyre. Si të tilla ato janë jashtë sferës së kontrollit të ndihmësit ligjor, prandaj, duke qenë objektive nuk mund t'i atribuohen performancës sime profesionale dhe nuk janë të asaj shkalle që ndikojnë dhe kushtëzojnë në mënyrë determinante performancën profesionale, për shkak edhe rezultateve të larta që kam arritur në testimin e njohurive profesionale në konkursin për pranimin dhe ndjekjen e programit teorik dhe praktik pranë Shkollës së Magjistraturës. Rezultate këto që sipas ligjit nr. 84/2016, përbëjnë një komponent për vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit.”

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, ka studiuar dhe analizuar raportin e Inspektoratit të KLD-së si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, duke pasur parasysh faktin që znj. Maela Alicanaj, ka pasur funksionin e ndihmëses ligjore, si dhe është njohur me rezultatet e testimit të Shkollës së Magjistraturës, për znj. Alicanaj, të cilat ishin “shumë të mira”.

Bazuar në sa më lart, arrihet në përfundimin se rezultati i rivlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, konsiston në sa vijon:

- i. Në tërësi konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale. Kjo për shkak se në drejtim të arsytimit ligjor subjekti i rivlerësimit argumenton ligjërisht mendimin e tij dhe propozon zgjidhje konkrete, edhe pse në disa raste janë konstatuar mangësi formale apo pozicionime disi të ndryshme;
- ii. Përgjithësisht, vlerësohet se relacionet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit pasqyrojnë rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet e ngritura në rekurs;
- iii. Gjithashtu, janë konstatuar raste në të cilat nuk është pasqyruar arsytim i plotë dhe gjithëpërfshirës i subjektit në lidhje me shkaqet e rekursit, duke evidentuar mangësi, të cilat mund të kenë qenë kalimtare. Kjo nënkupton se subjekti edhe pse në disa raste ka munguar që të përpilojë dhe analizojë aktet në formën e kërkuar, gjithsesi, i ka patur dhe i ka të gjitha mundësitë që të përmirësojë performancat e veta, duke qenë se ndërkohë ka ndjekur një vit shkollor në Shkollën e Magjistraturës dhe do të vijojë në plotësimin e formimit të saj profesional, jo vetëm nëpërmjet frekuentimit të Shkollës së Magjistraturës, por edhe duke fituar eksperiencë direkte përgjatë përfshirjes së saj në praktika konkrete.

Duke u bazuar në sa më lart, Komisioni, pasi ka kryer një rivlerësim tërësor të kriterit profesional, nëpërmjet një kombinimi të balancuar midis raportit të KLD-së, të sipërpërmendur dhe vlerësimit apo rezultatit të testimit profesional të kryer nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe vlerësimit të akteve në fjalë nga trupi gjykues, në raport me funksionin e subjektit dhe të prespektivës profesionale përmirësuese, çmon se znj. Maela Alicanaj, e plotëson kushtin e parashikuar nga germa “c” e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me aftësitë profesionale.

Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Maela Alicanaj, rivlerësuar në funksionin e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016;
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 24.7.2019

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Genta Tafa (Bungo)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka